

## Misri “Sulova”: trashëgimi dijesh kultivimi dhe përdorimi

Misri “**Sulova**” ka cikël të shkurtër zhvillimi, rreth 80 ditë, aftësi prodhuese të ulët, rreth 25-30 kv për ha, por i parapëlqyer për cilësinë e bukës”. Sipas dëshmive të të parëve, por edhe përshkrimeve teknike të bëra kohë pas kohe, misri “Sulova” është me shtat relativisht të shkurtër, koçan i hollë e me ngjyrë të bardhë, kokërr të vogël dhe me ngjyrë të bardhë, gjysmë qelqore. Buka e prodhuar nga mielli tij është e ëmbël dhe me një shije të veçantë.

Në rrjedhat e kohës deri në çlirim të vendit arat me bimën e misrit në këtë krahinë shtriheshin në kodra, në ngastra të vogla e të copëtuara. Ato toka mbajtën gjallë ndër shekuj breza të tërë. Punoreshin, ujiteshin, nëse kishte mundësi, dhe merreshin prodhime për atë popullsi të vogël që ishte, por ajo shtohej, shumohej e vëllazërohej. Me rritjen e popullsisë tokat nuk mjaftonin më për të siguruar bukën për gjithë vitin. Here pas here, që faktikisht ka vazhduar me ritme të ngadalta deri në vitet 40’ të shekullit të kaluar, shpyllëzohej pylli, shkurret për të hapur toka të reja, apo siç thuhet në Sulovë, “u hap rrah”.

Fatkeqësisht shumica e këtyre arave, që dikur, në shekuj, mbajtën me bukë brezat, sot janë kthyer në rrëpira prej erozionit. Ara të cilat në përgjithësi ishin copa toke, që kishin madhësi të ndryshme, më së shumti 2-3 dynym, të shpërndara dhe larg njëra-tjetrës, të rrethuara me gardhe, pemë të larta e shkurre, me vija uji pranë, pjesa më e madhe ishin në vende të sheshta, në brinjë kodrash e buzë përrenjsh, që në të shumtën e rasteve ujiteshin me ujët e burimeve dhe përrenjve. Me një kultivim tradicional dhe primitiv, në këto toka prodhoheshin kryesisht drithëra buke, më së shumti misër, grurë, elb dhe thekër, që i përshtateshin klimës së krahinës dhe kërkesave të banorëve.

Gjurmët e “hap rrah”, gjenden edhe sot në mikrotoponime, që, në të shumtën e rasteve mbajnë emrat e pronarëve të dikurshëm. Dhe këtë e jep shumë qartë eksploratorja angleze Misis Edith Durham në librin e saj “Bregë e Ballkanasve”, faqe 293, e cila në vitet e para të shekullit XX, kaloi në krahinën e Sulovës. Ajo shkruan: “...Gati një çereku i tokës është i punuar, por brenda disa pyjeve aty pranë shihej se po hapeshin disa toka të reja të cilat ishin të shëndosha ...”.

Tokat buzë përrenjve shpesh përmyteshin dhe për këtë arsye mbeteshin të papunuara, të mbuluar me ferra, driza, zhuka. Këtë e tregojnë mikrotoponimet e vjetra: Zhavarja, Moçali, Zhuka, Verrishtja, Ligata etj. Megjithëse tokën e kanë pasur të pakët dhe në kohëra punohej me mjete të thjeshta, kazmë e parmendë, por me kujdes dhe në këto kushte të vështira, vetëkuptohet që rendimentet dhe prodhimet e ishin të ulëta, por gjithsesi bujqit dinin t’i bënin ngastrat e tyre prodhuese dhe, me vështirësi, mundoheshin të përballonin nevojën për sigurimin e bukës.

Pozicioni gjeografik i zonës, elementët klimatikë, si dhe gjendja ekonomike e popullsisë, ishin faktorë që kushtëzonin kultivimin e bimës së misrit. Është e vërtetë se nuk donte shërbime të shumta, punime, plehërime, ujitje, por me ato pak shërbime që i bëheshin fshatarët shpërbleheshin me prodhim të mirë.

Është me shumë rëndësi të theksojmë se, në atë periudhë kur u fut ky misër, populli vuante nga krizat e bukës, që ishin të shpeshta dhe merrnin jetë njerëzish. Në popull ende ka mbetur e gjallë shprehja: *“Misri largoi vdekjet nga uria”*. Ai ishte e vetmja bimë që mbillej edhe në bashkëshoqërim me kultura të tjera, veçanërisht fasule, fshesë, kungull, bostan, gjë që jepte mundësinë për një shfrytëzim më të mirë të tokës dhe për sigurimin nga e njëjta sipërfaqe të prodhimeve të shumë llojeve, sa që dhe sot dëgjohet thënia: *“Arat e mbjellja me misër të japin jo vetëm bukë por edhe gjellë”*.

**Përgatitja e tokës:** Toka punohej me parmendë druri. **Zgjedhja e farës** si dhe gjetja e kohës me të mirë për mbjellje ishin dy anë të rëndësishme për misrin “Sulova”. Fara e misrit ndahej gjatë procesit të zhveshjes. Kallinj të më të mirë ndahen për farë dhe nga ata merrej pjesa e mesme e kallirit. Një mendim i ngulitur në vetëdijen popullore ishte: *“Farën e misrit nuk duhet as ta përfolje, lëvdoje e as ta mallkoje”*.

**Koha e mbjelljes:** Prilli ishte periudha më e përshtatshme për mbjelljen e misrit. Për mbjelljen zbatoheshin zakone të dala nga përvoja, si afate për punimin, plehërimin dhe mbjelljen, nga e cila varej në një farë mase edhe prodhimi i pritshëm. Për shembull, për plehërimin me pleh organik bagëtish, thuhej se para punimit të tokës duhet të hidheshin dy-tre kosha për një vath vend; ose për mbjelljen ishte formuar mendimi se *“Kur hëna ishte e plotë nuk mbillej sepse farën e ha krimbi”*. Tjetër koncept: *“kur dheu bëhet grusht, e dora e futur në tokë ndjen të ftohtë, mendohej se ishte ende herët”*, etj. Koha e përshtatshme, si shenjë paralajmëruese për fillimin e mbjelljes, konsiderohej *“kur fiku çel tre gjethë”*. Bujku kishte edhe disa shenja të tjera me të cilat përcaktonte kohën e fillimit të mbjelljeve, sikurse: *“Kur merimangat endnin fijet e tyre mbi tokë, që do të thoshte se toka ishte gati për të mbjellë...”*, ose *“vendosja e të ndenjurrave në tokë dhe po të ndjenin ftohtë, nuk duhej të mbillej”*.

**Mbjellja bëhej në dy forma:** mbjellje me shpërndarje dhe mbjellje me vijë (brazdë), ku fara hidhej në çdo vijë të tretë (brazdë); d.m.th, në dy vija (brazda) parmenda kalonte bosh dhe në një plot. Veç mbjelljes misri kishte edhe procese të tjera pune gjatë rritjes dhe zhvillimit të bimës, si rrallime, prashitje, etj. E nëse ndonjë arë kishte mundësi për ujitje, në rast thatësie të madhe, kur bimët kishin nevojë për lagështi, duhej bërë edhe ujitja.

**Vjelja:** Misri vilej kur piquej mirë. Vihej kapicë në arë, pastaj këputej e futej në koçek (magazina të vogla përgatitura me thupra). Gjatë dimrit bëhej zhveshja e tij dhe çohej për bluarje në mulli. Prodhimi sigurisht ishte i vogël, por ishte i mirë si cilësi. Kush mbushte koçekun dhe siguronte gjysmën e vitit me bukë kishte gëzim të madh.

Në dekadat e fundit të shekullit XX, me zhvillimin ekonomik e social të vendit dhe futjen në përdorim të farërave hibride, që japin rendimente të larta, mbjellja e misrit “Sulova” u reduktua dukshëm dhe mbeti vetëm në disa kopshte të vogla familjare, që në total nuk i kalonin 30-50 ha.

**Prof. Dr. Sokrat Jani**  
**Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve, UBT**  
**Tiranë, Albania**